



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 12.12.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 30.11.2023.

Shoqëria PASTRIME SILVIO shpk i është drejtuar Bashkisë Himarë nëpërmjet kërkesës datë 30.11.2023 ku kërkon informacion mbi zbatimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Nr. 64 (86-2023-920), datë 25.09.2023

Sqarojmë se Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit Nr. 64 (86-2023-920), datë 25.09.2023. ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë;
- Shfuqizimin e Vendimit Nr. 474/2022, datë 16.05.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik;
- Detyrimin e Komisionit të Prokurimit Publik të marrë masa për kthimin në buxhetin e shtetit të tarifës administrative të parapaguar nga ankuesi Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria tregtare “Alko Impex General Construction” d.sh.h dhe shoqëria tregtare “Alko Impex Construction” sh.p.k.;
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera;
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur;
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv, menjëherë të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor;
- E drejta e rekursit kundër këti vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Theksojmë se kërkesa padia e shoqërisë PASTRIME SILVIO shpk dhe & AEK& KO shpk ka patur për objekt.

- Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar efektet e aktit administrativ Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 474/2022, datë 16.5.2022;
- Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 474/2022, datë 16.5.2022;
- Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të datës 19.4.2022, si dhe Njoftimin e Fituesit të datës 21.4.2022 të autoritetit kontraktor Bashkia Himarë;

- Shfuqizimin e marrëveshjes kuadër apo çdo kontrate që mund të lidhë autoriteti kontraktor me bashkimin e operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” dshh dhe shoqëria “Alko Impex Construction” shpk, gjatë gjykimit të kësaj kërkesë padie.

Sa më sipër, rezulton se Gjykata ka shfuqizuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik por në asnjë rast nuk ka shfuqizuar ndonjë akt të autoritetit kontraktor Bashkia Himarë apo të ketë urdhëruar Bashkinë Himarë për kryerjen e ndonjë veprimi tjetër.

Në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit Nr. 64 (86-2023-920) datë 25.09.2023, gjykata lidhur me kërkimet e tjera të paditësit në kërkesëpadi është shprehur se lidhur me zgjidhjen e pasojave të shfuqizimit të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik gjykata konstaton se duhet bërë vetëm kthimi i tarifës së paguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga bashkimi operatorëve ekonomik “Alko Impex General Construction” d.sh.h dhe shoqëria tregtare “Alko Impex Construction” sh.p.k.

Përsa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka ngarkuar me asnjë detyrë apo detyrim Bashkinë Himarë për kryerjen e ndonjë veprimi.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!